



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri: KSC-BC-2020-06

Vendosi: Gjykatësi i procedurës paraprake
Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 26 tetor 2020

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Versioni i redaktuar publik i urdhrorit për transferim në objektin e paraburgimit të
Dhomave të Specializuara**

Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Mbrojtësit të Rexhep Selimit

T'i dorëzohet

Rexhep Selimit

UNË, GJYKATËS NIKOLA GIJU, gjykatës i procedurës paraprake i Dhomave të Specializuara të Kosovës, i caktuar prej Kryetares së Dhomave të Specializuara në përputhje me nenin 33(1)(a) të Ligjit nr. 05/L-53 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”);

PASI KAM MARRË parashtrimet konfidenciale dhe *ex parte* të Zyrës së Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) me tituj “Parashtrim i Aktakuzës për konfirmim” të datës 24 prill 2020, “Kërkesë për fletarrestime dhe urdhra në lidhje me to” të datës 28 maj 2020, dhe “Parashtrim i Aktakuzës së Rishikuar për konfirmim” të datës 24 korrik 2020;

PASI KAM KONFIRMUAR Aktakuzën e Rishikuar (“Aktakuza e Konfirmuar”) në “Vendim për konfirmimin e Aktakuzës kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit” të datës 26 tetor 2020, dhe pasi kam konstatuar aty se ekziston dyshim i bazuar mirë se z. Rexhep Selimi (“z. Selimi”) ka kryer ose ka marrë pjesë në kryerjen e veprave penale brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara, përkatësisht krimet kundër njerëzimit të përndjekjes, burgosjes, akteve të tjera çnjerëzore, torturës, vrasjes së paligjshme dhe zhdukjes me forcë, dhe krimet e luftës së ndalimit arbitrar, trajtimit mizor, torturës dhe vrasjes së paligjshme, përkatësisht në shkelje të neneve 13(1) dhe 14(1)(c) të Ligjit;

PASI KAM KONSTATUAR se ekzistojnë arsye të artikulueshme për të besuar se arrestimi i z. Selimi është i domosdoshëm;

PASI KAM LËSHUAR fletarrestim për z. Selimi, gjithashtu i njohur si “Dhjetëshi”, “Agroni”, “Tafili”, ose “Lulzimi”, i lindur më 15 mars 1971 në Aqarevë, Komuna e Skënderajt, Kosovë, aktualisht me shtetësi kosovare, numri personal i identifikimit: [REDAKTUAR], me adresë të fundit personale të njohur: [REDAKTUAR], Prishtinë, Kosovë;

DUKE MARRË SHËNIM “Vendim për caktimin e vendit të zhvillimit të procedurës në shtetin pritës” të datës 21 shtator 2020, në të cilin Kryetarja e Dhomave të

Specializuara caktoi vendin e zhvillimit të kësaj procedure në Holandë (“shteti pritës”);

BAZUAR NË nenet 3(8)(a) dhe (d), 39(3), 41(5) dhe (7), 53 dhe 55 të Ligjit dhe rregullat 50, 55(4) dhe (6) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës;

URDHËROJ Administratoren e Dhomave të Specializuara që këtë urdhër për transferim t’ia përcjellë Kosovës, ose cilitdo shteti të tretë, dhe shtetit pritës;

URDHËROJ Administratoren të bëjë përgatitjet e nevojshme për transferimin pa vonesë të z. Selimi në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara në shtetin pritës, në koordinim me ZPS-në dhe autoritetet kompetente të Kosovës, ose të shteteve të treta përkatëse, dhe ato të shtetit pritës;

URDHËROJ Administratoren që gjatë përcjelljes së këtij urdhri për transferim, të kërkojë ndihmë veçanërisht për: (i) kalimin e sigurt dhe të papenguar të z. Selimi dhe zyrtarëve përcjellës, si edhe të të gjitha gjësendeve të tyre, nëpër kontrole kufitare dhe pika të tjera kontrolli; (ii) pranimin e dokumenteve të udhëtimit dhe identifikimit të lëshuara nga shteti pritës ose Dhomat e Specializuara; dhe (iii) garantimin e sigurisë së çdo avioni dhe/ose mjeti tjetër të transportit të përdorur për një transferim të tillë dhe mundësimin e kalimit të papenguar të ekuipazheve të tyre nëpër kontrollet kufitare shtetërore, në qoftë se është e nevojshme:

- a. lidhur me Kosovën: ta urdhërojë që t’i përcjellë Administratores çfarëdo të dhënash ose informacioni të rëndësishëm në lidhje me transferimin e z. Selimi, dhe rikujtojë se, duke marrë parasysh përparësinë e Dhomave të Specializuara kundrejt të gjitha gjykatave të tjera në Kosovë, autoritetet kosovare duhet të përmbushin këtë urdhër, në përputhje me nenin 53(2) dhe (3) të Ligjit, duke mundësuar në këtë mënyrë zbatimin e transferimit të z. Selimi; dhe ta rikujtojë se, në rast se një subjekt, një zyrtar i Qeverisë së Kosovës apo cilido person tjetër në Kosovë, pengon zbatimin e këtij urdhri

ose shkel kushtet e tij, kjo mund të përbëjë shkelje, në përputhje me nenin 15(2) të Ligjit;

- b. lidhur me shtete të treta: të kërkojë prej tyre të ofrojnë ndihmë për zbatimin e transferimit të z. Selimi, në përputhje me nenin 55 të Ligjit, dhe informojnë Administratoren pa vonesë për datën, orën, vendin dhe çfarëdo hollësie tjetër të rëndësishme lidhur me arrestimin dhe transferimin e z. Selimi në Dhomat e Specializuara, në përputhje me nenin 55 të Ligjit. Në lidhje me këtë, në rast të vështirësive apo pengesave teknike ose logjistike gjatë zbatimit të këtyre urdhrave, autoritetet kompetente të shteteve të treta përkatëse ftohen që të informojnë përfaqësuesit e ZPS-së dhe/ose të Zyrës Administrative, sipas rastit, për këto vështirësi ose pengesa;

URDHËROJ Administratoren të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për garantimin e sigurisë operative dhe të sigurisë së z. Selimi dhe të cilitdo zyrtari ose punonjësi tjetër të gjykatës gjatë transferimit e deri në mbërritjen e tyre në vendin e paraburgimit në shtetin pritës, përfshirë parashtrimin e kërkesave të nevojshme shtetit pritës dhe shteteve të treta (të transitit);

VENDOS që ky urdhër për transferim, aktualisht i klasifikuar si rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, mund t'u komunikohet, ose ekzistenca e tij mund t'u bëhet e ditur, autoriteteve kompetente të Kosovës, të një shteti të tretë, dhe të shtetit pritës, në qoftë se kjo është e nevojshme për zbatimin e tij; dhe

URDHËROJ ZPS-në që t'ia përcjellë Administratores të gjithë informacionin e disponueshëm që mund të ndihmojë në zbatimin e këtij urdhri për transferim, si edhe çfarëdo informacioni tjetër të rëndësishëm për vlerësimin e rrezikut të mundshëm ndaj viktimave dhe dëshmitarëve që lidhet me arrestimin dhe transferimin e z. Selimi.

/nënshkrim/

Gjykatës Nikola Giju

Gjykatës i procedurës paraprake

E hënë, 26 tetor 2020

Në Hagë, Holandë.